



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 59

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9082
datë 19.6.2003

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për projektin e rehabilitimit dhe të ndërtimit të spitalit të Shkodrës”.....

2485

Ligj nr.9083
datë 19.6.2003

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin bashkiak të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të qyteteve Lezhë, Durrës, Fier dhe Sarandë”.....

2507

Ndreqje gabimi

2521

L I G J
Nr.9082, datë 19.6.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT DHE TË NDËRTIMIT TË SPITALIT TË SHKODRËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për projektin e rehabilitimit dhe të ndërtimit të spitalit të Shkodrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3888, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë, Alfred Moisiu

RREGULLAT
E HUASË SË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS

KAPITULLI I
OBJEKTI I RREGULLAVE TË HUASË

Neni 1

Objekti i këtyre rregullave është të përcaktojë kushtet e përgjithshme që udhëheqin Huatë e dhëna nga Banka dhe garancitë e huave.

Neni 2

Banka nëpërmjet kushteve në kontratat e huave ose të garancive, mund të sigurojë përjashtime për kushtet e përcaktuara në këto rregulla.

Neni 3

Në rast konflikti mes kushteve të këtyre rregullave dhe një ose më shumë kushteve të kontratave të huave ose të garancive, kushtet e fundit do të mbizotërojnë.

KAPITULLI 2
KUSHTET QË UDHËHEQIN DHËNIEN E HUAVE DHE GARANCIVE NGA BANKA

Neni 4

Banka do të japë Hua për financimin e veprimeve që janë në përputhje me objektivat e saj.

Neni 5

Banka do t'u japë hua qeverive që janë anëtare të tij ose personave ligjorë të atyre qeverive që sigurojnë Bankën me garancitë e specifikuara në nenin VII, seksioni 1(b) të neneve të Marrëveshjes.

Banka mund të përcaktojë kërkesat e garancive ndryshe nga ato që i referohen paragrafit paraardhës. Në mungesë të garancive zyrtare nga ana e qeverisë anëtare që dorëzoi aplikimin për huanë, e njëjta qeveri do t'i japë Bankës një premtim solem, duke premtuar në veçanti se do të marrë të gjitha hapat e nevojshme për mbulimin e huasë në fjalë.

Neni 6

Banka do të vendosë nëse garancia e specifikuar në seksionin paraardhës do të jepet nëpërmjet një kontrate të veçantë midis Bankës dhe garantuesit ose me anë të miratimit në fund të kontratës së huasë nga garantuesi.

Neni 7

Kontrata e huasë dhe, atje ku gjen zbatim kontrata e garancisë përkatëse, do të specifikojë detyrimet e huamarrësit dhe të garantuesit.

Në çdo rast detyrime të tilla do të lidhen me:

- a) shumën e shumave për t'u shlyer, monedhën në të cilën është shprehur Huaja dhe monedhën në të cilën do të kryhet pagesa;
- b) datën e shlyerjes së huasë;
- c) normën e interesit në të cilën jepet huaja, norma e ndonjë ngarkese tjetër të specifikuar në kontratë, shumat e interesit dhe të ngarkesave në fjalë, datat në të cilat do të pranohet pagesa dhe monedha në të cilën kryhen këto pagesa;
- d) informacionin që do t'i sigurohet Bankës nga huamarrësi mbi përdorimin e huasë.

Neni 8

Detyrimet financiare të huamarrësit që jepen në paragrafin (a), (b) dhe (c) të nenit 7 më sipër, do të paraqiten në një tabelë shlyerje si shtojcë e kontratës së huasë.

Neni 9

Garantuesi do të lirohet nga detyrimet e tij me anë të ekzekutimit të tyre, por derisa ai t'i ketë përmbushur ato. Këto detyrime nuk do të jenë subjekt i çdo kërkesë mbi ose çdo veprimi kundër garantuesit; gjithsesi ato do të jenë subjekt i një njoftimi nga Banka për garantuesin, duke e informuar këtë të fundit mbi dështimin e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kundrejt Bankës.

Detyrimet e garantuesit nuk do të ndikohen nga zgjatja e afatit, nga lëshimi ose lehtësimi dhënë huamarrësit, as nga ndonjë mbrojtje ose dështim për të kërkuar çdo të drejtë ose kompensim kundër huamarrësit ose lidhur me çdo siguri për huanë, as nga ndonjë dështim i huamarrësit për t'u përshtatur me çdo kërkesë të ligjit, vendimit ose rregullave të garantuesit ose të çdo autoriteti politik ose administrativ të garantuesit.

Neni 10

Banka do të mobilizojë huatë e saj duke i kërkuar huamarrësve të firmosin letrat me vlerë, kryesisht notën premtuese, notat e regjistruara ose çdo letër tjetër me vlerë, në përputhje me zakonet dhe metodat e ndjekura në të tilla transaksione.

Nëse do të ketë një garantues, garantuesit i kërkohet të aprovojë letrat me vlerë.

Këto letra me vlerë do t'i dërgohen Bankës, jo më vonë se dita në të cilën kontratat e huasë

dhe atje ku gjen zbatim, kontrata e garancisë përkatëse, hyjnë në fuqi.

Çdo çështje tjetër lidhur me letrat me vlerë do të rregullohet me anë të kontratës së huasë dhe kontratës së garancisë.

KAPITULLI 3

PEZULLIMI DHE ANULIMI I HUAVE PARA MATURIMIT, KTHIMI I HUAVE PARA MATURIMIT, KËRKESAT PËR SHLYERJEN E HUAVE

Neni 11

Një huamarrës që anulon ose pezullon të gjithën ose pjesë të huasë përpara se të jetë shlyer në tërësi ose me këste, do t'i kërkohet që të kompensojë Bankën për humbjen e shkaktuar si rezultat i këtij anulimi ose pezullimi duke paguar një komision të vetëm në normën, që do të vendoset nga Banka lidhur për pjesën e huasë së anuluar ose pezulluar. Nëse do të ketë një garantues, ky nen do të aplikohet gjithashtu dhe për garantuesin.

Përgjegjësia financiare e huamarrësit dhe garantuesit siç përcaktohet në paragrafin paraardhës, do të lindë sapo të jetë njoftuar Banka për pranimin e termave të transaksionit të Huasë, siç përcaktohet në rezolutën e Këshillit Administrativ që jep huanë. Një pranim i tillë do të thotë pranimi i këtyre rregullave.

Neni 12

Një huamarrës me vendim të Bankës mund të jetë i autorizuar të shlyejë huanë para maturimit. Kushtet e kësaj shlyerjeje do të përcaktohen nga Banka.

Neni 13

Banka mund të pezullojë ose anulojë ose të kërkojë shlyerje në rastet e mëposhtme:

a) nëse huamarrësi ose garantuesi dështon të shlyejë principalin ose të paguajë interesin ose çdo shumë tjetër të duhur sipas kontratës së huasë ose kontratës së garancisë midis Bankës dhe huamarrësit, ose sipas kontratës së huasë ose kontratës së garancisë ndërmjet Bankës dhe Garantuesit, dështimet e tyre lidhen qoftë me kontratën në fjalë ose me çdo kontratë tjetër që kanë të njëjtin huamarrës ose garantues;

b) nëse huamarrësi ose garantuesi dështon të përmbushë detyrimin që lind nga çdo specifikim tjetër ose klauzolë të këtyre rregullave ose nga një kontratë huaje, nga një kontratë garancie ose letër me vlerë, dështimi lidhet qoftë me kontratën në fjalë ose me çdo kontratë tjetër me të njëjtin huamarrës ose garantues dhe nëse interesat dhe objektivat e Bankës janë paragjykuar si rrjedhim;

c) nëse një situatë e jashtëzakonshme shfaqet që bën të pasigurt përmbushjen e detyrimeve të huamarrësit ose të garantuesit;

d) nëse huamarrësi ose garantuesi merr ose autorizon çdo masë, ose vendos, ose lejon të ndërmerret çdo procedurë, nëpërmjet së cilës çdo pronë që i përket atij është ose do të mund t'i caktohet, transferohet ose jepet në një farë mënyre një marrësi zyrtar të autorizuar, likujduesit ose tjetër personi, personi caktohet qoftë nga huamarrësi, gjykata ose garantuesi, ose veprohet në përputhje me ndonjë ligj dhe atje ku ka një masë e tillë, ose procedurat rezultojnë, ose sigurojnë për shpërndarjen e pronësisë së tillë ndërmjet kreditorëve të huamarrësit ose garantuesit;

e) nëse garantuesi ose çdo autoritet qeveritar kompetent merr çdo masë për të shkrirë ndërmarrjen ose të mbyllë aktivitetet e huamarrësit, ose të pezullojë operacionet e tij;

f) nëse huamarrësit ose garantuesit i ndalohet e drejta për të qenë një anëtar i Bankës;

g) nëse ndërmerret çdo veprim që përbën një dhunim të kontratave, pasi të jenë firmosur dhe të mos kenë hyrë ende në fuqi kontratat e Huasë dhe ajo e Garancisë;

h) nëse shfaqet ndonjë ngjarje tjetër e specifikuar në kontratën e huasë ose të garancisë, duke i dhënë zbatim këtij neni.

Neni 14

Nëse lind ndonjë nga ngjarjet e përshkruara në nenin 13, Banka mund në çdo kohë të pezullojë të gjithën ose pjesë të pagesës së huasë duke e njoftuar huamarrësin dhe garantuesin.

Pezullimi do të përfundojë në datën në të cilin Banka njofton huamarrësin dhe garantuesin se mbyllja e pezullimit nuk është më gjatë operuese.

Neni 15

Nëse shfaqet ndonjë nga ngjarjet e përshkruara në nenin 13, Banka mund gjithashtu, duke njoftuar huamarrësin dhe garantuesin, të anulojë përgjithmonë huanë në tërësi ose pjesë të saj. Një vendim i tillë, anulimi i huasë mund të merret pas një pezullimi.

Neni 16

Nëse shfaqet ndonjë nga ngjarjet e përshkruara në nenin 13, Banka mund të kërkojë gjithashtu shlyerje të menjëhershme në tërësi ose pjesë të huasë të paguar në përputhje me një ose më shumë kontrata huaje, së bashku me interesin dhe ngarkimet përkatëse, duke njoftuar huamarrësin dhe garantuesin, duke siguruar se:

a) ndonjë nga ngjarjet e parashikuara në nenin 13(a), mbizotëron për më shumë se tridhjetë ditë;

b) një nga ngjarjet e parashikuara në paragrafin (b) të të njëjtit nen, mbizotëron për më shumë se gjashtëdhjetë ditë.

Neni 17

Nëse Banka mban një humbje si rezultat i pezullimit, anulimit ose kërkesës për shlyerje, siç thuhet në nenet 14,15 dhe 16, do të paguhet një komision i vetëm i specifikuar në nenin 11. Në rast kërkesë për shlyerje të shumës së komisionit, që do të vendoset nga Banka, do të llogaritet sipas shumës së përgjithshme të huave, për të cilat kërkohet pagesa.

KAPITULLI 4 PËRCAKTIMI I MOSMARRËVESHJEVE LIDHUR ME HUATË NGA BANKA OSE GARANCITË PËRKATËSE

Neni 18

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kontratës së huasë dhe atje ku gjen zbatim, të kontratës së garancive lidhur me interpretimin ose ekzekutimin e këtyre kontratave ose lidhur me padinë e njërit prej palëve në fjalë kundër tjetrit që ka nga kontrata e huasë, kontrata e garancisë, këto rregulla ose letra me vlerë, të cilat nuk janë zgjidhur me marrëveshje mes palëve do t'i nënshtrohen arbitrazhit në mënyrën e përshkruar më poshtë.

Neni 19

Procedurat e arbitrazhit mund të caktohen nga cilado prej palëve të specifikuara në seksionin paraardhës me anë të një kërkesë që i njoftohet të gjitha palëve të tjera.

Kërkesa do të specifikojë natyrën dhe subjektin e mosmarrëveshjes dhe do të parashikojë paditë që i nënshtrohen arbitrazhit.

Neni 20

Në çdo procedurë arbitrazhi të caktuar në përputhje me këtë nen, Huamarrësi ose Garantuesi (në ka), mund të jetë pjesëmarrës përkrah Garantuesit ose Huamarrësit, siç mund të jetë rasti.

Neni 21

Për çdo mosmarrëveshje të dërguar për arbitrazh në përputhje me këtë nen, mund të formohet një trup gjykues. Ai do të konsistojë nga tre arbitra të caktuar si më poshtë:

- a) një arbitër do të caktohet nga Banka;
- b) arbitri i dytë do të caktohet nga huamarrësi ose, atje ku gjen zbatim, nga marrëveshja midis huamarrësit dhe garantuesit ose, nëse dështon kjo marrëveshje, nga garantuesi;
- c) arbitri i tretë, i quajtur mbiarbitër, i cili do të veprojë si President i trupit gjykues, do të caktohet me pëlqimin e përbashkët të palëve ose nëse një pëlqim i tillë dështon, nga Presidenti i Gjykatës Europiane të të Drejtave Humane, ose ky i fundit ka kombësinë e garantuesit, ose ka të njëjtën kombësi me atë të Huamarrësit, nga zv/Presidenti i Gjykatës ose, nëse ky i fundit gjendet në të njëjtën situatë, nga më i madhi i gjykatësve të gjykatës, të cilët kanë qoftë kombësinë e Garantuesit, qoftë të njëjtën kombësi si huamarrësi;
- d) procedura e përshkruar në paragrafin paraardhës do të zbatohet me iniciativën e njërës prej Palëve mosmarrëveshëse, nëse brenda një muaji pas dhënies së njoftimit të kërkesës së arbitrazhit, nuk është mbyllur asnjë marrëveshje lidhur me caktimin e një mbiarbitri;
- e) nëse njëra nga Palët nuk cakton arbitër, mbiarbitri do të caktojë arbitrin.

Neni 22

Trupi gjykues do të zhvillojë seancën e tij të parë në datën dhe vendin e caktuar nga mbiarbitri. Pas kësaj, trupi do të vendosë ku dhe kur do të mbahet.

Neni 23

Trupi gjykues do të vendosë për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencat e tij. Do të përcaktojë rregullat e tij procedurale dhe do të zgjedhë ligjin që do të zbatohet, nëse ky i fundit nuk është parashikuar në kontratat ose në marrëveshjen e arbitrazhit, duke pasur parasysh kushtet e nenit 1(3) të protokollit të tretë të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës. Të gjitha vendimet e trupit do të merren me shumicë votash.

Neni 24

Të gjitha gjykimet e trupit gjykues do të përbëjnë bazën për vendim. Ato do të jenë përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët të parashikuara në nenin 18. Ato mund të ekzekutohen edhe nëse nuk janë pranuar.

Neni 25

Pala kundër së cilës merret gjykimi, do të suportojë kostot e procedurave të arbitrazhit, nëse trupi gjykues nuk vendos ndryshe ose Palët të kenë rënë dakord ndryshe me anë të një klauzole në kontratën e huasë ose në kontratën e garancisë. Trupi gjykues do të japë vendimin përfundimtar për çdo mosmarrëveshje lidhur me kostot.

Neni 26

Kontrata e huasë dhe kontrata e garancisë do të përmbajë çfarëdo kushtesh të kërkuara për të siguruar përshtatjen me vendimet e bëra në përputhje me këtë kapitull, përsa i përket Bankës, huamarrësit dhe garantuesit.

Neni 27

Nëse brenda një muaji pasi origjinalet e gjykimeve i janë dhënë palëve, gjykimi nuk është në përputhje, cilado nga palët e specifikuar në nenin 18 mund të hartojë procedura për ekzekutimin e gjykimit. Gjykata që ka autoritetin për këto procedura do të jetë ajo, e caktuar nga Procedura Civile e

shtetit që ka lidhje.

KAPITULLI 5 DATAT E HYRJES NË FUQI DHE E MBARIMIT TË KONTRATAVE TË HUAVE DHE TË KONTRATAVE TË GARANCIVE

Neni 28

Data e hyrjes në fuqi të një kontrate huaje ose të një kontrate garancie do të specifikohet në tekst. Mund të specifikohet me një kusht, rast në të cilin kontrata nuk do të hyjë në fuqi derisa ai kusht të jetë përmbushur. Nëse Banka nuk mund të ketë dijeni për përmbushjen e kushtit pa qenë e informuar, Huamarrësi dhe Garantuesi do të kryejnë njoftimet e nevojshme.

Në asnjë rast kontrata e huasë dhe e garancisë nuk do të hyjnë në fuqi ose shuma e huasë të jetë paguar, nëse të shumtën ditën e hyrjes në fuqi, Banka nuk ka përvetësuar letrat me vlerë të transaksionit, të përgatitura në formën e duhur dhe të firmosura nga huamarrësi dhe garantuesi.

Nëse kushti që udhëheq hyrjen në fuqi të një kontrate huaje ose të një kontrate garancie, nuk përmbushet, ose nëse ka një vonesë lidhur me vënien në dispozicion për Bankën të letrave me vlerë, nëse Banka rezulton me një humbje, huamarrësit ose garantuesit, do t'i kërkohej t'i paguajë Bankës një komision të vetëm në normën që do të caktohet nga Banka lidhur me shumën e specifikuar në kontratën e huasë.

Neni 29

Kontrata e huasë dhe kontrata e garancisë dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas tyre, do të përfundojnë sapo shuma e plotë e pricipalit të huasë dhe, atje ku gjen zbatim, premiumi për shlyerje të parakohshme të letrave me vlerë, si dhe të të gjitha interesave dhe ngarkesave të tjera të lindura dhe të mbledhura sipas kushteve të këtyre rregullave lidhur me huanë ose garancinë e huasë të jenë paguar.

KAPITULLI 6 KUSHTE TË NDRYSHME

Neni 30

Çdo njoftim ose kërkesë, e cila duhet ose mund të jepet, ose bëhet sipas kushteve të këtyre rregullave ose kontratave të huasë ose kontratave të garancisë, do të jepen ose bëhen me shkrim.

Neni 31

Kontratat e huasë dhe kontratat e garancisë mund të hartohen në më shumë se një kopje, secila do të konsiderohet si origjinale.

Neni 32

Këto rregulla janë hartuar në anglisht dhe në frëngjisht, të dyja versionet janë të barabarta.

KUADËR MARRËVESHJEJE **HUAJE NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE** **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (këtu dhe më pas e quajtur “ceb”), Paris, nga njëra anë dhe Republika e Shqipërisë nga ana tjetër:

duke pasur parasysh aplikimin e Qeverisë së Shqipërisë të datës 18 tetor 2000;

duke pasur parasysh Rezolutën e Këshillit Administrativ të CEB-it: 1424(1997) rish.3;

duke pasur parasysh protokollin e tretë të marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës;
duke pasur parasysh nenet e rregullores së huave të CEB-it të datës 6 tetor 1970 (botimi nëntor 1999),
kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Kjo hua është dhënë sipas kushteve të përgjithshme të rregullores aktuale të huave të CEB-it dhe sipas kushteve të veçanta të fiksuara me këtë Marrëveshje dhe anekset e saj.

Neni 2

Projekti

CEB-i i jep Huamarrësit, i cili e pranon, një hua për financimin e pjesshëm të F/P 1385 të aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it më 26 janar 2001 ("data e aprovimit") lidhur me financimin e pjesshëm të rehabilitimit dhe të ndërtimit të spitalit të Shkodrës.

Kjo hua jepet nga CEB-i duke pasur parasysh angazhimin që merr Huamarrësi për ta përdorur atë vetëm për financimin e projektit të parashikuar në aneksin I dhe për ta kryer këtë projekt sipas kushteve, të cilat janë të detajuara në aneksin në fjalë.

Çdo ndryshim në mënyrën e përdorimit të huasë, i cili nuk ka marrë aprovimin e CEB-it, mund të çojë në pezullimin, anulimin ose menjëherë në ripagimin e përshpejtuar të huasë, sipas termave të nenit 13 të rregullores së huave.

Neni 3

Huaja

3.1 Kushtet financiare

Shuma e aprovuar e huasë së dhënë është e barabartë me:

Dollarë amerikanë 2 260 000

(dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë dollarë amerikanë).

Huaja do të disbursohet në disa këste.

3.2 Tarifa të disbursimit dhe të jodisbursimit

Një letër anësore e këtij Kuadri Marrëveshjeje, i cili specifikon detajet, shumën, normën e interesit, datën e disbursimit dhe udhëzimet e pagesës të secilës Palë, sikurse dhe një grafik shlyerje, do të hartohet në kohën e disbursimit të çdo kësti në një formë, e cila si përmbajtje do të jetë e ngjashme me modelin e bashkëngjitur në aneksin II.

Për disbursimet do të hapet një llogari e veçantë në Bankën e Shqipërisë.

Shuma e huasë do të disbursohet me disa këste referuar përparimit të projektit. Disbursimi i parë duhet, gjithsesi, të ndodhë e shumta brenda 24 muajve nga data e aprovimit të projektit.

CEB-i do t'i ngarkojë Huamarrësit një tarifë jodisbursimi të përvitshëm prej 0,50% të pagueshme çdo tremujor me parapagim, kur nuk është arritur një shumë kufi minimale për disbursimet si më poshtë:

i) në qoftë se shumat e disbursuara gjatë 33 muajve të parë pas datës së aprovimit përfaqësojnë më pak se 20% të shumës së aprovuar;

ii) në qoftë se shumat e disbursuara gjatë 39 muajve të parë pas datës së aprovimit përfaqësojnë më pak se 30% të shumës së aprovuar;

iii) në qoftë se shumat e disbursuara gjatë 51 muajve pas datës së aprovimit përfaqësojnë më pak se 50% të shumës së aprovuar.

3.3 Mobilizimi

Me qëllim mobilizimin e huasë, Huamarrësi do të lëshojë në kohën e duhur tek CEB-i, për çdo këst një notë premtuese të veçantë, si modeli i dhënë në aneksin III.

Nota premtuese do të lëshohet dhe do të jetë e pagueshme në dollarë amerikanë.

3.4 Vendi

Të gjitha shumat, detyrim i Huamarrësit, sipas kësaj huaje janë të pagueshme ndaj CEB-it në

dollarë amerikanë dhe në numrin e llogarisë së komunikuar Huamarrësit nga CEB-i në kohën e disbursimit të çdo kësti. Fakse ose njoftime SWIFT duhet t'i dërgohen CEB-it nga banka e caktuar nga Huamarrësi për të kryer pagesat, me një njoftim të paktën 5 ditë-pune përpara për çdo pagesë.

3.5 Data

Dispozitat e nenit 3 janë subjekt i "Konventës së modifikuar të ditës së punës ndjekëse", definicioni i së cilës, gjendet në aneksin IV të Kuadrit të Marrëveshjes së huasë aktuale ("Ditë-pune" nënkupton një ditë-pune në vendin e monedhës).

Neni 4

Monitorimi i huasë dhe projektit

4.1. Përdorimi i huasë

4.1.1 Njësia e koordinimit të projektit

Ky projekt do të zbatohet nga njësia e koordinimit të projektit (PCU) nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

4.1.2 Periudha

Çdo pjesë e kështit të huasë duhet të përdoret nga Huamarrësi për financimin e projektit brenda 6 muajve pas disbursimit të tij nga CEB-i.

Pjesa e huasë e kthyer, e cila nuk është përdorur ose dhënë brenda një periudhe të tillë, duhet t'i ripaguhet CEB-it e shumta brenda 30 ditëve.

Huamarrësi merr përsipër të mbulojë kostot që rezultojnë nga ky ripagim. Kjo kosto do të korrespondojë me atë që do të përballonte CEB-i si rezultat i zëvendësimit të së njëjtës shumë në datën e ripagimit për jetën e mbetur të Huasë origjinale. Norma e zëvendësimit do të vendoset nga CEB-i mbi bazën e kushteve të tregut në datën e ripagimit dhe për periudhën në fjalë. Kostoja, për pasojë, do të përlllogaritet duke marrë parasysh diferencën mes normës origjinale dhe normës së zëvendësimit.

Përveç kësaj, nëse shumat e një kësti të huasë të disbursuar nga CEB-i nuk u jepet kontraktorëve ose u jepet vetëm pjesërisht kontraktorëve, brenda një periudhe të tillë, kjo do të krijojë një ngjarje që do të shkaktojë vënien në zbatim të nenit 13 të rregullores së huave të CEB-it.

4.1.3 Procedurat

Përpara çdo disbursimi ndaj kontraktorëve, Huamarrësi, përmes PCU-së, do t'i dërgojë Guvernuesit për aprovim, brenda periudhës së caktuar në nenin 4.1.2 më sipër, një faqe të dhënash mbi përbërësit që kanë të bëjnë me të (aneksi V) duke përmbledhur karakteristikat e çdo përbërësi, datën e fillimit të tij dhe gjendjen e përparimit të tij.

4.2 Zbatimi i projektit

4.2.1 Dispozita të përgjithshme

Huamarrësi do të tregojë gjithë kujdesin dhe aftësitë dhe do të shfrytëzojë të gjitha mjetet tipike të përdorshme, veçanërisht financiare, teknike, shoqërore dhe mjetet menaxheriale, si dhe ato lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat do të jenë të nevojshme për zbatimin e duhur të projektit.

Në veçanti, ai do të sigurojë, para se të zbatohet projekti, se ekzistojnë të gjitha të drejtat financiare për tokën dhe pronën e paluajtshme dhe se mirëmbahen dhe sigurohen në mënyrë të vazhdueshme të gjitha asetet dhe instalimet.

Huamarrësi, do të marrë përsipër, për më tepër, që:

- Projekti përputhet me konventat përkatëse të Këshillit të Europës;
- Projekti respekton mjedisin, mbi bazat e konventave ndërkombëtare përkatëse;
- financimet e pjesshme të CEB-it nuk e kalojnë 50% të kostos totale të projektit, duke përfshirë taksat, përqindjet e interesit dhe detyrimet financiare.

4.2.2 Kushtet e disbursimit

Para se të bëhet disbursimi i parë, Ministria e Shëndetësisë duhet t'i paraqesë CEB-it një vlerësim të numrit dhe të profilit të personelit të nevojshëm për departamentet e rehabilituara sipas këtij projekti dhe para se të kryhet disbursimi i fundit, duhet dhënë konfirmimi për emërimin e personelit në departamentet e rehabilituara, bazuar në numrin dhe profilet e kërkuara, sikurse dhe për nevojat për trajnim për këtë personel.

4.2.3 Prokurimi

Çdo prokurim punimesh, mallrash dhe shërbimesh që do të financohet sipas projektit nga të

ardhurat e huasë së CEB-it, do të kryhet në përputhje me udhëzimet e Bankës Botërore për prokurimet, rishikuar në janar 1999, duke përdorur dokumentin standard të tenderimit të Bankës Botërore (maj 2000) dhe udhëzimet e Bankës Botërore për zgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve, rishikuar në janar 1999.

Procedurat e prokurimit janë përcaktuar në aneksin VI.

4.3 Raportimet e Huamarrësit

Së paku, dy herë në vit, nga disbursimi i huasë deri në plotësimin e tërë projektit, Huamarrësi përmes PCU-së, duhet t'i dërgojë CEB-it, një raport të detajuar mbi:

- gjendjen e përdorimit të huasë;
- ecurinë e planit të financimit të projektit;
- ecurinë e vetë projektit;
- hollësi të menaxhimit të projektit;
- vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe rezultatet;
- kopje të kontratave përfundimtare.

Aneksi V specifikon procedurat lidhur me këtë raport dhe veçanërisht, modelin e formularëve të monitorimit për projektin dhe huanë, të cilët duhen të përfshihen së paku vetëm ato.

4.3.2. Raporti i përfundimit të projektit.

Me përfundimin e tërë projektit, Huamarrësi, përmes PCU-së, duhet të sigurojë, që CEB-i të marrë një raport përfundimtar, që përmban një vlerësim mbi efektet ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore të projektit.

4.4 Dhënia e informacionit ndaj CEB-it.

Huamarrësi, përmes PCU-së, duhet të mbajë regjistrime kontabiliteti që kanë të bëjnë me Projektin, të cilat do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe që në çdo pikë do të tregojnë gjendjen e përparimit të Projektit dhe të cilat do të regjistrojnë çdo veprim të kryer dhe do të identifikojnë asetet dhe shërbimet e financuara me ndihmën e kësaj huaje.

Huamarrësi, përmes PCU-së, duhet t'i auditojë çdo vit llogaritë e projektit nga një ekspert auditues i pavarur i pranueshëm për CEB-in. Auditimi do të financohet nga kjo hua. Huamarrësi duhet t'i dërgojë CEB-it sa më parë që të jetë e mundur, por sidoqoftë jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti, një kopje të vërtetuar të një auditimi të tillë nga eksperti auditues në fjalë.

Huamarrësi, përmes PCU-së merr përsipër të presë në mënyrë të favorshme çdo mision informimi të ndërmarrë nga punonjësit e CEB-it ose nga konsulentë të jashtëm të punësuar nga CEB-i dhe të japë të gjithë kooperimin e nevojshëm për misionin e tyre të informimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në vendin e projektit.

Huamarrësi, përmes PCU-së, merr përsipër t'i përgjigjet brenda një periudhe të arsyeshme kohe, çdo kërkesë të CEB-it për informacion dhe t'i japë çdo dokument që CEB-i e konsideron të nevojshëm për zbatimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht lidhur me monitorimin e projektit të përshkruar në aneksin I dhe përdorimin e huasë.

Huamarrësi, përmes PCU-së duhet ta njoftojë menjëherë CEB-in për çdo amendament legjislativ ose rregullator në sektorin ekonomik të lidhur me Projektin, përshkruar në aneksin I, dhe në një kuptim të përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë ndikim në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Kuadri Marrëveshjeje huaje.

Çdo amendament legjislativ a rregullator në sektorin ekonomik të lidhur me projektin, përshkruar në aneksin I, do të krijojë një ngjarje siç është renditur në nenin 13 të kapitullit 3 të rregullores së huasë të CEB-it dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose menjëherë pagimin e përshpejtuar të huasë.

Neni 5

Mbydhja e detyrimeve të Huamarrësit

Pagimi i shumës-detyrim, si parashikuar në notën premtuese, e çliron Huamarrësin nga detyrimet e përcaktuara në nenin 3 më sipër.

Pasi të paguhet siç duhet e tërë shuma e vlerës kryesore të kësaj huaje dhe të gjitha interesat dhe shpenzimet e tjera që rezultojnë prej saj, veçanërisht ato shuma të parashikuara nga nenet 6 dhe 7 më poshtë, Huamarrësi do të çlirohet plotësisht nga detyrimet e tij ndaj CEB-it, përveç atyre të vendosura në nenin 4 më sipër.

Neni 6
Interesi për vonesat

Pavarësisht nga çdo mbështetje tjetër e bërë e mundur prej CEB-it, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe rregullores së huasë, ose ndryshe nëse Huamarrësi nuk i paguan të gjitha interesat ose ndonjë shumë tjetër të pagueshme sipas këtij Kuadri Marrëveshjeje huaje, e shumta në datën e detyrimit të specifikuar, Huamarrësi duhet të paguajë interesat shtesë mbi shumën-detyrim dhe të papaguar plotësisht, me normën një mujore Libor të pagesës së vonuar nga data e duhur (nëse nuk është një ditë-pune Target, dita paguese e punës) në orën 11 a.m. (ora lokale në Londër) plus 2.5% në vit që nga data e duhur e kësaj shume deri në datën e pagesës aktuale. Norma e aplikueshme njëmujore Libor do të riazhurnohet çdo 30 ditë.

Neni 7
Shpenzime shoqëruese

Të gjitha detyrimet dhe taksat e të gjitha llojeve, detyrime dhe të paguara, dhe të gjitha shpenzimet që rezultojnë si nga përfundimi, ekzekutimi, likuidimi, anulimi ose pezullimi i kësaj marrëveshjeje, në tërësi ose pjesërisht, ose nga garancia a rifinancimi i huasë së dhënë, së bashku me të gjitha veprimet juridike dhe juridike-suplementare, që kanë si origjinë këtë hua, do të përballohen nga Huamarrësi.

Sidoqoftë, dispozitat e nenit 25 të kapitullit 4 të rregullores së huasë të CEB-it do të zbatohen lidhur me shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të përmendura në këtë kapitull 4.

Neni 8
Siguritë

Huamarrësi deklaron se nuk është bërë, as nuk do të bëhet në të ardhmen ndonjë angazhim, që do t'i jepte një palë të tretë një vend preferencial, një të drejtë preferenciale pagese, një kolateral ose garanci të çfarëdo lloj natyre, që mund t'i japë të drejta të rritura palëve të treta (këtu dhe më pas quajtur "siguri").

Nëse një siguri e tillë i është dhënë megjithatë një palë të tretë, Huamarrësi bie dakord të krijojë ose të japë një siguri identike në favor të CEB-it ose, kur nuk mund ta bëjë këtë, një siguri ekuivalente, dhe të rezervojë formimin e një sigurie të tillë në favor të CEB-it.

Dështimi në përmbushjen e këtyre dispozitave do të përbënte një rast gabimi siç parashikohet në nenin 13 të kapitullit 3 të rregullores së huasë të CEB-it dhe mund t'i japë shkas pezullimit, anulimit ose ripagimit të menjëhershëm të huasë.

Neni 9
Marrëdhëniet me palët e treta

Huamarrësi nuk mund të ngrejë asnjë fakt të lidhur, brenda qëllimit të përdorimit të huasë, me marrëdhëniet e tij me palë të treta, me qëllim evitimin e përmbushjes, si të plotë ose të pjesshme të detyrimeve që rezultojnë nga ky Kuadër Marrëveshjeje huaje. CEB-i nuk do të përfshihet në mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe kostot e çfarëdo lloj natyre, të ndërmarra nga CEB-i për shkak të çfarëdo mosmarrëveshjeje dhe, veçanërisht, të gjitha kostot ligjore dhe gjyqësore, do të mbulohen me shpenzimet e Huamarrësit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Kuadër Marrëveshjeje huaje do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit me anë të të cilit Parlamenti i Huamarrësit e ka ratifikuar këtë Kuadër Marrëveshjeje huaje.

Neni 11
Ligji i aplikueshëm

Ky Kuadër Marrëveshje huaje dhe siguritë e negociueshme që lidhen me të do të guvernohen nga rregullat e CEB-it, siç është specifikuar në dispozitat e nenit 1 paragrafi 3 të protokollit të tretë shtesë të datës 6 mars 1959 të Marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës të datës 2 shtator 1949 dhe, në radhë të dytë, nëse është e nevojshme nga legjislacioni francez. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshje do të jenë subjekt i arbitrazhit sipas kushteve të paraqitura në kapitullin 4 të rregullores së huasë të CEB-it.

Neni 12
Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron se ka njoftim për rregulloren e huave të CEB-it dhe ka marrë një kopje të saj. Kur ka kontradikta ndërmjet ndonjë dispozite të rregullores së huave të CEB-it dhe ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, do të kenë prioritet.

Titujt e paragrafëve, seksioneve dhe kapitujve të këtij Kuadri Marrëveshjeje huaje nuk do të shërbejnë për interpretimin e saj. Në asnjë rast nuk do të prezumohet se CEB-i ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga ndonjë e drejtë që i jepet atij nga kjo Marrëveshje.

Neni 13
Ekzekutimi i një titulli arbitrazhi

Palët Kontraktuese bien dakord të mos përfitojnë nga ndonjë privilegj, imunitet ose legjislacion para çdo autoriteti juridiksional ose tjetër, vendas ose ndërkombëtar, në mënyrë që të kundërshtojnë zbatimin e një titulli të paraqitur në kushtet e formuluar në kapitullin 4 të rregullores së huave të CEB-it.

Neni 14
Përfaqësimi dhe garanci

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- se organet e tij kompetente e kanë autorizuar atë të nënshkruajë këtë Marrëveshje dhe i kanë dhënë kështu nënshkruesit (nënshkruesve) autorizimin për këtë, në përputhje me ligjet, dekretet, rregulloret, nenet shoqëruese dhe dokumente të tjerë të aplikueshëm për të;

- se bëra dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërshtim me ligjet, dekretet, rregulloret dhe dokumente të tjerë të aplikueshëm për të dhe se janë marrë të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme dhe se do të mbeten të vlefshme për gjithë periudhën e huasë.

Çdo ndryshim lidhur me përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme duhet, për gjithë periudhën e huasë, t'i njoftohet menjëherë CEB-it dhe t'i jepen të gjitha dokumentet mbështetëse.

Neni 15

Ky Kuadër Marrëveshje huaje është hartuar në dy kopje origjinale në anglisht, secila me vlerë të barabartë.

Një origjinal mbahet nga secila prej Palëve Kontraktuese.

Aneksi I

Sintezë e Projektit

I F/P	1385 (2000)
Huamarrësi	Republika e Shqipërisë
Shuma e akorduar	Deri në 2 260 000 dollarë amerikanë

II

Zonat e veprimit	Rehabilitimi dhe ndërtimi i spitalit të Shkodrës
------------------	--

Punimet e planifikuara:	Projekti konsiston kryesisht në punimet e mëposhtme: 1. Rehabilitimi i ndërtesës së maternitetit, i cili përfshin repartet e obsetrikës dhe gjinekologjisë. Ndërtesa ka një sipërfaqe totale prej 3 547 17 m2 nga e cila 375m2 janë rehabilituar tashmë në katin e dytë me fondet e ECHO. Sipërfaqja totale që duhet rehabilituar prej 3 172 17m2 ndahet si më poshtë: - Kati përdhes 1,257. 24m2 - Kati i parë 1,077. 07m2 - Kati i dytë 396. 78m2 (nga një total prej 771.78m2) - Kati i tretë 441.08 m2 2. Ndërtimi i repartit të radiologjisë, me një sipërfaqe totale prej 317.17m2, cili do të lidhë ndërtesën e maternitetit me ndërtesat e tjera. 3. Instalimi i një inceneratori dhe rehabilitimi i dhomës ku do të vendoset. Inceneratori do të ketë kapacitet të trajtojë 150 kg/orë mbeturina, çka është e mjaftueshme për tërë spitalin. 4. Lidhur me pajisjet, projekti nuk do të furnizojë pajisje për repartet e rehabilituara, por për dy të tjera (repartet ambulatorie dhe laboratorin) ku nevojiten shumë pajisje të reja. - Reparti i radiologjisë, duke përfshirë dy dhoma radiologjie, 1 dhomë ekografie, 1 mamografie, 1 fluoroskopie dhe 1 CT skaneri, tri dhoma për personelin dhe një dhomë ekzaminimi e zhvillimi filmash. - Reparti i lindjeve, që përfshin dy salla lindjeje, 2 dhoma paralindjeje, 4 dhoma për personelin dhe një dhomë për të porsalindurit. - Reparti i maternitetit, që përfshin 7 dhoma ekzaminimi & trajtimi, 8 dhoma për personelin dhe 60 shtretër. - Reparti ambulator, që përfshin 7 dhoma ekzaminimi dhe trajtimi, 8 dhoma për personelin, 4 dhoma vizitash dhe 3 dhoma endoskopije. - Laboratori Projekti do të mbështesë gjithashtu studime paraprake për investimet e propozuara si studimet arkitektuale dhe projektuese dhe planin e pajisjeve. Ai do të përfshijë: (a) projektet paraprake dhe finale arkitektuale; (b) përgatitjen e dokumenteve të tenderit për punimet civile; (c) pjesëmarrje në vlerësimin e ofertës për punime civile; (d) vlerësimin e nevojave për pajisje dhe lista e detajuar e veçorive teknike për çdo tip pajisjeje. Projekti përmban komponentë të ndryshëm, hollësitë e të cilëve do t'i konfirmohen CEB-it në kohën e prokurimit. Së fundi, Projekti do të financojë shpenzimet e auditimeve vjetore të llogarive të Projektit, si dhe disa shpenzime operative për njësinë koordinuese të Projektit.
Menaxhimi i projektit:	Njësia e koordinimit të projektit (PCU)
Lokalizimi:	Shkodër
Plani i financimit:	Kostoja totale e investimeve: afërsisht 5 520 000 USD, të mbuluar nga: CEB-i: deri në 2 260 000 USD Republika e Shqipërisë: për t'u konfirmuar Republika e Shqipërisë duhet të konfirmojë mundësinë nga ana e saj të financimit përpara disbursimit të parë nga CEB-i.

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EUROPËS

Letër anësore e Kuadrit të Marrëveshjes së huasë të datës (data) ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (e quajtur në vazhdim “CEB”) dhe Republikës së Shqipërisë (e quajtur në vazhdim “Huamarrësi”)

Kjo letër anësore dhe Kuadri i Marrëveshjes së huasë përcaktojnë afatet dhe kushtet për të cilat është rënë dakord për kështu e parë duke iu referuar nenit (numri) të këtij Kuadri Marrëveshjeje huaje.

Vlera e huasë dollarë amerikanë.....

Maturimi(numri) – viti i fundit i maturimit me një periudhë pa kamatë
prej (numri) vjetësh (ose (numri) – viti bullet)

Norma e interesit e lëvizshme Libor 6 muaj plus ose minus (numri) pikë baze (neto)
në vit
(Telarate (referenca) ose Reuters (Referenca))

Pagesa e interesitÇdo gjashtë muaj me prapapagesë

Fraksioni i numërimitaktual/360, Konventa e modifikuar e ditës së punës
të ditëvepasardhëse

Ditë-puneDo të thotë një ditë-pune në vendin e monedhës

Data e disbursimit(data)

Udhëzime për pagesënNumri i llogarisë (numri) i (emri i bankës dhe qyteti))
SWIFT

Code: (cipher) nëpërmjet (emri i bankës korresponduese dhe qyteti) SWIFT CODE (cipher).

Teksti për normën bazë Libor dhe strukturën e amortizimit të huasë

Norma e interesit do të llogaritet për çdo periudhë (numri) mujore, duke nisur nga dita e datës së disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë-pune (në Londër) para çdo periudhe të re interesi, sipas “British Bankers’ Association”. CEB-i do të informojë Huamarrësin mbi interesin që duhet paguar çdo (numri) muaj. Pagesa e interesit do të bëhet me (dita, muaji)¹ çdo vit dhe për herë të parë me (data). Principali do të paguhet për herë të parë më (data).

(të renditen datat e maturimit dhe shuma kryesore e detyruar për çdo datë)

Teksti për normën bazë LIBOR dhe strukturën e huasë “bullet”

Norma e interesit do të llogaritet për çdo periudhë (numri) mujore, duke nisur nga data e datës së disbursimit. Interesi do të caktohet dy ditë-pune (në Londër) para çdo periudhe të re interesi, sipas “British Bankers Association”. CEB-i do të informojë Huamarrësin mbi interesin që duhet paguar çdo (numri) muaj. Pagesa e interesit do të bëhet me (dita, muaji)² çdo vit dhe për herë të parë me (data). Principali do të paguhet në një herë me (data).

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it në (emri i bankës dhe qyteti)

Këto dispozita janë objekt i marrëveshjes “Konventa e modifikuar e ditës së punës pasardhëse”, përkufizimi i së cilës gjendet në aneksin (numri) e Kuadrit të Marrëveshjes së huasë, nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit me (data).

Për ta mobilizuar këtë kështu huaje, Huamarrësi duhet t’i dërgojë në kohën e duhur CEB-it një notë premtuese që i korrespondon këtij kësti (shih shtojcën 1).

(Qyteti, data)

Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Europës

(Qyteti, data)

Për (emri i huamarrësit)

Shtojca III/A

Normë e fiksuar interesi

¹ të përmenden 4 datat për pagesat tremujore dhe 2 datat për pagesat gjashtëmujore.

Notë premtuese
(monedha) (shuma) (data)

Për vlerën e marrë, Republika e Shqipërisë:
nëpërmjet kësaj note premtimi angazhohet t'i paguajë Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës ose të tjerëve, shumën kryesore prej:
(Shuma me fjalë) (Monedha me fjalë),
me këtë në datat e caktuara në vazhdim dhe interesat, siç është caktuar çdo gjashtë muaj.
Në datat e caktuara më poshtë, pagesa do të bëhet siç përcaktohet në vazhdim për një shumë totale që përmban rimbursimin e detyruar të principalit dhe interesin mbi balancën e papaguar të principalit.

(Data) (Monedha) (Shuma)

Pagesa e sipërme do të bëhet në:

(Bankën korresponduese të CEB-it dhe referencat e llogarisë), në favor të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, pa zbritje nga ose mbi llogari të ndonjë prej taksave, tatimeve a detyrimeve të tjera të tanishme ose të ardhshme të imponuara ose të marra kundër kësaj note ose përfitimeve të saj nga ose brenda shtetit nënshkrues ose ndonjë organizimi politik a tatimvënës të tij.

Kjo notë premtimi përbën një lidhje me huanë e dhënë nga Banka për Zhvillim të Këshillit të Europës Huamarrësit me datë (data e disbursimit).

Në rast mospagese të shpejtë dhe të plotë të shumave të detyruara sipas kësaj note premtimi, tërë principalit dhe interesi në datën e pagesës do të bëhen të detyruara dhe do të paguhen sipas zgjedhjes dhe me kërkesën e mbajtësit të saj.

Moszbatimi nga ana e mbajtësit të saj i të drejtave të mësipërme nuk përbën ndonjë përjashtim nga të drejtat e tij në këtë ose instanca të tjera.

Për Republikën e Shqipërisë
F/P 1385 (2000)- kësti 0/gradë)

Shtojca III/B
(Norma e interesit e lëvizshme)

Notë premtimi
(monedha) (shuma)(data)

për shumën e marrë, Republika e Shqipërisë:
Nëpërmjet kësaj note premtimi angazhohet t'i paguajë Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës ose të tjerëve, shumën principale prej:

(Shuma me fjalë) (Monedha me fjalë),
me këtë siç përcaktohet më poshtë:

(data): (monedha) (shuma)

(data): (monedha) (shuma)

(data): (monedha) (shuma)

(data): (monedha) (shuma)

.... /

dhe me interesat siç përcaktohet në nenin 3.1 të Kuadrit të Marrëveshjes së huasë nënshkruar me (data).

Pagesat e mësipërme do të bëhen në:

(Bankën korresponduese të CEB-it dhe referencat e llogarisë),
në favor të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, pa zbritje të ose mbi llogari të ndonjë prej taksave, tatimeve a detyrimeve të tjera të tanishme ose të ardhshme të imponuara ose të marra kundër kësaj note ose përfitimeve të saj nga ose brenda shtetit nënshkrues ose ndonjë organizmi politik a tatimvënës të tij.

Kjo notë premtuese përbën një lidhje me një hua të dhënë nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës Huamarrësit me datë (data e disbursimit).

Në rast mospagese të shpejtë dhe të plotë të shumave të detyruara sipas kësaj note premtuese, tërë principali dhe interesi në datën e pagesës do të bëhen të detyruara dhe do të paguhën sipas zgjedhjes dhe me kërkesën e mbajtësit të saj.

Moszbatimi nga ana e mbajtësit të saj i të drejtave të mësipërme nuk përbën ndonjë përjashtim nga të drejtat e tij në këtë instancë ose ndonjë tjetër.

Për Republikën e Shqipërisë

Aneksi IV

KONVENTA E MODIFIKUAR E DITËS SË PUNËS PASARDHËSE

(Cito:)

Seksioni 4.12 Konventa e ditës së punës. (a) “Konventa e ditës së punës” është Konventa për rregullimin e ndonjë date të rëndësishme, nëse ajo do të binte në një ditë që nuk është ditë-pune. Termat e mëposhtëm, kur përdoren në lidhje me termin “Konventa e ditës së punës” dhe me një datë, do të thotë që rregullimi do të bëhet nëse kjo datë do të binte në një datë që nuk është ditë-pune, kështu:

... (omissis)...

Nëse “e modifikuar pasardhëse” ose “e modifikuar” është e specifikuar, kjo datë do të jetë e para ditë-pune që pason, përveç rastit kur kjo ditë bie në muajin tjetër kalendarik dhe atëherë, kjo datë do të jetë e para ditë e mëparshme që është ditë-pune.

... (omissis)...

(b)...(omissis)...

(mos cito:)

(“International Swap Dealers Association Inc.1991 Definitions”).

Aneksi V

KOSTOJA TOTALE E PROJEKTIT NË MONEDHË TË HUAJ

Data.....

[illegible]

Tabela 2Aneksi V

Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës

Përdorimi i Huasë së CEB-it

Vendi: Shqipëria

Projekti: F/P 1385 (2000) – Spitali i Shkodrës

Huaja e aprovuar: 2 260 000 USD, i.e. 50% e kostos së pranuar

Në USD

Data e kontratës a	Tipi i Kontratës b	Kontraktues c	Vlera e kontratës d	Shuma e paguar e	% e paguar f=e/d	Modifikime Komente g
Totali						

Tabela 3 Aneksi V

Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës

Burimet financiare
Detajim i fondeve të marra

Vendi: Shqipëria
Projekti: F/P 1385 (2000) – Spitali i ShkodrësData.....

Në USD

Burimet e financimit	Tremujori I viti	Tremujori II viti	Tremujori III viti	Tremujori IV viti	Tremujori I viti	Tremujori II viti	Tremujori III viti	Tremujori IV viti	Totali	Modifikime komente
CEB										
Qeveria										
Donatorë të tjerë (*)										
Shpenzime totale										

(*) Ju lutemi përcaktoni donatorët kur ka

Tabela 4Aneksi V

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EUROPËS

GRAFIKU I PUNIMEVE
GRAFIKU I PUNIMEVE DHE PËRPARIMI

Diagramë

Vendi: Shqipëria

Projekti: F/P 1385 (2000) – Spitali i ShkodrësData.....

Buxheti i punimeve	Tremujori I viti	Tremujori II viti	Tremujori III viti	Tremujori IV viti	Tremujori I viti	Tremujori II viti	Tremujori III viti	Tremujori IV viti	% e punimeve fizike të kryera	Modifikime komente
Studime investimi										
Prokurimi										
Punime civile										
Pajisje										

..... Kalendari fillestar i projektit të punimeve

----- Kalendari i riparë i punimeve

_____ Punimet e kryera

Tabela 5 Aneksi V

Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës

Objektivat fizikë dhe socialë

Vendi: Shqipëria

Projekti: F/P 1385 (2000) – Spitali i Shkodrës Data.....

Përshkrimi i punimeve të infrastrukturës të parashikuara	Treguesit fizikë e socialë për tip infrastrukture	Objektivat e parashikuar	Objektivat e arritur	Modifikime komente
Rehabilitim, ndërtim dhe pajisje	Numri i ndërhyrjeve kirurgjikale	5000		
	Numri i tomografive në vit	4100		
	Numri i fluoroskopive në vit	4000		
	Numri i mamografive	6000		
	Numri i radiografive në vit	20000		
	Numri i diagnostikimeve me ultratinguj në vit	8000		
	Numri i lindjeve në vit	8000		
	Numri i përfituesve	300000		

☐

Seksion për përdorim të brendshëm nga CEB-i

☐

Seksion që duhet plotësuar nga përfituesi

Aneksi VI

BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EUROPËS

Kategoria	Vlera e kontratës (\$ 000)	Metoda e prokurimit
Mallra	Mbi 100	ICB
	Ndërmjet 10 dhe 100	Tregti ndërkombëtare
	Nën 10	Tregti
		Të tjera
Punime	Mbi 750	ICB
	Ndërmjet 250 dhe 750	NCB
	Nën 250	Tre kuota
		Të tjera
Konsulentë	Mbi 150 për firmat	QCBS (zgjedhja e bazuar në koston e kualifikimit)
	Nën 150 për firmat	QSB (zgjedhja e kualifikimit bazë)
	Mbi 50 për privatët	LCS (zgjedhja e koston më të ulët)
	Nën 50 për privatët	Kualifikime

L I G J
Nr.9083, datë 19.6.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN BASHKIAK TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË KANALIZIMEVE TË QYTETEVE LEZHË, DURRËS, FIER DHE SARANDË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin bashkiak të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të qyteteve Lezhë, Durrës, Fier dhe Sarandë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.3889, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**E KREDISË PËR ZHVILLIM (PROJEKTI BASHKIAK PËR UJIN DHE KANALIZIMET)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM**

Marrëveshje, datë 20 mars 2003 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA):

ndërsa (A) Huamarrësi, plotëson kërkesat e tij përsa i përket bëshmërisë dhe prioritetit të projektit përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), ka kërkuar nga IDA të ndihmojë në financimin e projektit;

(B) Projekti do të zbatohet nga ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Durrës, ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Fier, ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Lezhë dhe ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Sarandë, me ndihmën e Huamarrësit dhe, si pjesë e kësaj asistence, Huamarrësi do të bëjë të disponueshme të ardhurat e kredisë të përfshira në artikullin II të kësaj Marrëveshjeje (kredia) të disponueshme për ndërmarrjen e ujë-kanalizimeve Durrës, ndërmarrjen e ujë-kanalizimeve Fier, ndërmarrjen e ujë-kanalizimeve Lezhë, ndërmarrjen e ujë-kanalizimeve Sarandë, siç është parashtruar në këtë Marrëveshje;

ndërsa IDA ka rënë dakord mbi bazat e dyanshme të vazhdueshmërisë të zgjerojë kredinë për Huamarrësin mbi termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, në Marrëveshjen ndërmjet IDA-s dhe Qarkut Durrës dhe ndërmarrjen e ujë-kanalizimeve Durrës (Marrëveshja e Projektit Durrës), në Marrëveshjen ndërmjet IDA-s, Bashkia Fier dhe ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Fier (Marrëveshja e Projektit Fier), në Marrëveshjen ndërmjet IDA-s, Bashkia Lezhë dhe ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Lezhë (Marrëveshja e Projektit Lezhë) dhe në Marrëveshjen ndërmjet IDA-s, Bashkia Sarandë dhe ndërmarrja e ujë-kanalizimeve Sarandë (Saranda Marrëveshja e projektit);

tani për këtë arsye Palët këtu bien dakord si më poshtë:

Kushte të përgjithshme. Përkufizime

Seksioni 1.01 “Kushtet e përgjithshme” të aplikueshme për “Marrëveshjen për zhvillimin e kredisë” të IDA-s datë 1 janar 1985 (siç janë përmirësuar në 6 tetor 1999) (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Me përjashtim të rasteve kur konteksti nënkupton të kundërtën, termat e përcaktuar në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet respektive të parashtuara dhe termat e mëposhtëm shtesë kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Kategoria” do të thotë kategoritë e artikujve që do të financohen nga të ardhurat e kredisë siç janë parashtuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

b) “CMU” do të thotë njësia e monitorimit të kontratës e vendosur nga Huamarrësi për qëllimet e koordinimit dhe menaxhimit të projektit.

c) “Qarku Durrës” do të thotë rajoni i Durrësit përfshirë qytetet Durrës, Shijak, Krujë, qyteza e Fushë-Krujës, Sukthi dhe Manza, komunat e Katundit të Ri, Rrashbull, Maminas, Gjepalaj, Xhafzotaj, Ishëm, Bubq, Nikël, Kodër Thumanë dhe Cuthi të Huamarrësit ose ndonjë në vazhdim.

d) “EMPF” do të thotë struktura e planit për menaxhimin e mjedisit, që plotëson kërkesat e IDA-s, adaptuar nga Huamarrësi dhe paraqitur IDA-s në 23 korrik 2002, që parashtrojnë masat për lehtësimin e ndikimeve negative mbi mjedisin.

e) “Komiteti ekzekutiv” do të thotë Komiteti i vendosur nga Huamarrësi dhe Qarku Durrës, Bashkitë Fier, Lezhë dhe Sarandë për të siguruar udhëheqjen politike dhe mbikëqyrjen e implementimit të projektit.

f) “Raporti i monitorimit financiar” ose “FMR” do të thotë çdo raport i përgatitur në përputhje me seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

g) “FY” do të thotë viti fiskal i Huamarrësit duke filluar më 1 janar dhe duke mbaruar në 31 dhjetor të çdo viti.

h) “Fondi i investimeve” do të thotë fondi special i vendosur, administruar dhe mirëmbajtur nga Huamarrësi për qëllimet e financimit të investimeve kryesore në pjesën A të projektit për riparimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë në Durrës, Fier, Lezhë dhe Sarandë.

i) “Kontrata e menaxhimit” do të thotë shërbimi i kontratës i bazuar në performancë sipas të cilit NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS do të hyjnë në marrëveshje me operatorin për:

i) menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat e Durrësit, Fierit, Lezhës dhe Sarandës;

ii) rehabilitimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

j) “Bashkia Fier” do të thotë qyteti i Fierit ose në vazhdim i saj.

k) “Bashkia Lezhë” do të thotë qyteti i Lezhës ose në vazhdim i saj.

l) “Bashkia Sarandë” do të thotë qyteti i Sarandës ose në vazhdim i saj.

m) “Operator” do të thotë operatori privat i një ndërmarrjeje ujësjellësi të huaj me eksperiencë, që do të hyjë në kontratë menaxhimi me NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS.

n) “Marrëveshja e projektit Durrës” do të thotë Marrëveshja fillestare e kësaj date ndërmjet IDA-s, Qarkut Durrës dhe NUKD, dhe amendamentet, ashtu siç mund të bëhen me kalimin e kohës duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet suplementare të Marrëveshjes së Projektit.

o) “Marrëveshja e projektit Fier” do të thotë Marrëveshja fillestare e kësaj date ndërmjet IDA-s, Bashkisë Fier dhe NUKF dhe amendamentet, ashtu siç mund të bëhen me kalimin e kohës duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet suplementare të Marrëveshjes së projektit.

p) “Marrëveshja e projektit Lezhë” do të thotë dhe Marrëveshja fillestare e kësaj date ndërmjet IDA-s, Bashkisë Lezhë dhe NUKL dhe amendamentet, ashtu siç mund të bëhen me kalimin e kohës duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet suplementare të Marrëveshjes së projektit.

q) “Marrëveshja e projektit Sarandë” do të thotë dhe Marrëveshja fillestare e kësaj date ndërmjet IDA, Bashkisë Sarandë dhe NUKS, dhe amendamentet, ashtu siç mund të bëhen me kalimin e kohës duke përfshirë të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet suplementare të Marrëveshjes së projektit.

r) “Marrëveshjet e projektit” do të thotë Marrëveshjet kolektive referuar në paragrafët (n), (o),

(p) dhe (q) të këtij seksioni dhe termi “Marrëveshja e projektit” do të thotë secila prej Marrëveshjeve të projekteve.

s) “Parapagimi për përgatitjen e projektit” do të thotë parapagimi për përgatitjen e projektit të garantuar nga IDA për Huamarrësin në përputhje me letrën e marrëveshjes së nënshkruar për Palën e IDA-s në 1 dhjetor 1995 dhe për Palën e Huamarrësit më 26 dhjetor 1995.

t) “PIP” do të thotë plani i implementimit të projektit për zbatimin e projektit të përgatitur dhe të adaptuar nga Huamarrësi, siç mund të jetë përmirësuar herë pas here në marrëveshje me IDA-n.

u) “Llogari e veçantë” do të thotë llogaria e referuar në seksion 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

v) “Marrëveshje nënhuaje Durrës” do të thotë Marrëveshja e hyrë në fuqi ndërmjet Huamarrësit dhe NUKD në përputhje me seksionin 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje, ashtu siç ky mund të jetë përmirësuar herë pas here dhe ky term përfshin të gjitha shtojcat e marrëveshjes për dhënie borxhi.

w) “Marrëveshje nënhuaje Fier” do të thotë dhe Marrëveshja e hyrë në fuqi ndërmjet Huamarrësit dhe NUKF në përputhje me seksionin 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje ashtu siç ky mund të jetë përmirësuar herë pas here, dhe ky term përfshin të gjitha shtojcat e marrëveshjes për dhënie Borxhi.

x) “Marrëveshje nënhuaje Lezhë” do të thotë Marrëveshja e hyrë në fuqi ndërmjet Huamarrësit dhe NUKL në përputhje me seksionin 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje, ashtu siç ky mund të jetë përmirësuar herë pas here, dhe ky term përfshin të gjitha shtojcat e marrëveshjes për dhënie borxhi.

y) “Marrëveshje nënhuaje Sarandë” do të thotë Marrëveshja e hyrë në fuqi ndërmjet Huamarrësit dhe NUKS në përputhje me seksionin 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje, ashtu siç ky mund të jetë përmirësuar herë pas here, dhe ky term përfshin të gjitha shtojcat e marrëveshjes për dhënie borxhi.

z) “Marrëveshjet për dhënie borxhi” do të thotë së bashku të gjitha marrëveshjet referuar në paragrafët (v), (w), (x) dhe (y) të këtij seksioni dhe termi “borxh” do të thotë secili prej borxheve të siguruar nën secilën prej Marrëveshjeve për dhënie borxhi.

aa) “NUKD” do të thotë ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve Durrës.

bb) “NUKF” do të thotë ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve Fier.

cc) “NUKL” do të thotë ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve Lezhë.

dd) “NUKS” do të thotë ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve Sarandë.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01 IDA bie dakord t’i japë Huamarrësit, në termat dhe kushtet parashtruar në ose referuar në Marrëveshjen për zhvillimin e kredisë, një shumë në monedha të ndryshme ekuivalente me njëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë SDR (11 400 000 SDR).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me kushtet e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose nëse IDA do të bjerë dakord, të bëhet), në bazë të kostove të arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen jashtë procedurave të kredisë.

b) Huamarrësi mundet, për qëllimet e projektit, të hapë dhe të mbajë në dollarë një llogari speciale në një bankë në termat dhe kushtet që plotësojnë kërkesat e IDA-s, duke përfshirë mbrojtjen e duhur kundrejt zhvendosjeve, konfiskimit ose bashkimit me një tjetër llogari. Depozitat dhe pagesat jashtë llogarisë speciale do të bëhen në përputhje me kushtet e shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Menjëherë pas datës efektive, IDA do të tërheqë për Palën e Huamarrësit nga llogaria e Kredisë dhe do të paguajë për vete shumën e kërkuar për të shlyer shumën fillestare të parapagimit për përgatitjen e projektit të tërhequr dhe të mbetur pa u paguar deri në atë datë, dhe të paguajë të gjitha detyrimet e papaguara deri aty. Bilanci i patërhequr i shumës së autorizuar të parapagimit për përgatitjen e projektit që këtej e tutje do të anulohet.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes do të jetë 31 dhjetor 2009 ose një datë e tillë e mëvonshme, ashtu siç mund të kërkohej nga IDA. IDA do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për një datë të tillë të mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do të paguajë për IDA-n një tarifë angazhimi mbi shumën fillestare të Kredisë së patërhequr herë pas here sipas interesave që do të caktohen nga IDA në 30 qershor të çdo viti, por pa kaluar interesin prej një gjysëm të një përqindshit (1/2 të 1%) për vit.

b) Tarifa e angazhimit do të mbledhet: i) nga data 60 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (data e mbledhjes) në datat respektive në të cilat shumat respektive do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; ii) në interesin e përcaktuar në 30 qershor menjëherë para datës së mbledhjes dhe në tarifa interesi të tjera, siç mund të përcaktohen herë pas here pas kësaj në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Tarifa e përcaktuar në 30 qershor të çdo viti do të aplikohet nga data e ardhshme në vitin e specifikuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Tarifa e angazhimit do të paguhet: i) në vendin ku IDA do ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme; ii) pa kufizime të ndonjë lloji të bërë nga ose në territorin e Huamarrësit; iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme, ose në një monedhë tjetër të tillë të përshtatshme, siç mund të caktohet ose të seleksionohet herë pas here në përputhje me kushtet e këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do të paguajë për IDA-n një tarifë shërbimi në interesin e $\frac{3}{4}$ të një përqindshit ($\frac{3}{4}$ e 1 për qind) për vit mbi shumën fillestare të kredisë së tërhequr dhe të mbetur pa u shlyer herë pas here.

Seksion 2.06 Tarifat e angazhimit dhe tarifat e shërbimit do të jenë të pagueshme në gjashtëmuorë në 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti.

Seksioni 2.07 (a) Subjekt për paragrafët (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të shlyejë shumën fillestare të kredisë në këtë gjashtëmuorë të pagueshme në 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti duke filluar nga 1 shkurti i vitit 2013 dhe duke përfunduar më 1 gusht 2022. Çdo këst do të jetë pesë për qind (5%) të shumës fillestare.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet këtu poshtë për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij në objektivat e projektit, siç janë parashtruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me këtë ai: (i) do të zbatojë pjesën C të Projektit me diligjencën dhe efikasitetin e duhur dhe konform praktikave të duhura administrative dhe financiare dhe do të sigurojë, menjëherë sipas nevojës fondet, facilitetet shërbimit dhe të tjera burime të kërkuara për këtë pjesë të projektit; ii) pa asnjë kufizim ose ndikim mbi ndonjërin nga kushtet e tjera nën këtë Marrëveshje kredie për zhvillim, do të ndërmarrë ose do të bëjë të ndërmerren të gjitha veprimet duke përfshirë sigurimin e fondeve të tilla si fondet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e projektit, faciliteteve, shërbimeve dhe të tjera burime, të nevojshme ose të duhura për të aftësuar Qarkun e Durrësit, NUKD, Bashkinë Fier, NUKF, Bashkinë Lezhë, NUKL, Bashkinë Sarandë dhe NUKS të kryejnë punën e tyre në përputhje respektive me kushtet e Marrëveshjes së projektit Durrës, Marrëveshjes së projektit Fier, Marrëveshjes së projektit Lezhë, Marrëveshjes së projektit Sarandë, po ashtu si edhe me PIP dhe

kontratën e menaxhimit, dhe nuk do të ndërmarrë ose të lejojë të ndërmerret asnjë veprim i cili do të pengonte ose ndërhynte me këtë performancë.

b) Huamarrësi do të rikthejë jashtë të ardhurave të kredisë: (i) shumën e alokuar herë pas here nën kategoritë (1)(a), (2)(a), (3)(b) dhe (5)(a) tek NUKD; (ii), shumën e alokuar herë pas here nën kategoritë (1)(b), (2)(b), (3)(c) dhe (5)(b) tek NUKF; (iii) shumën e alokuar herë pas here nën kategoritë (1)(c), (2)(c), (3)(d) dhe (5)(c) tek NUKL; (iv) shumën e alokuar herë pas here nën kategoritë (1)(d), (2)(d), (3)(e) dhe (5)(d) tek NUKS nën Marrëveshjet e nënshkruara që do të bëhen respektivisht ndërmjet Huamarrësit dhe NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS nën termat dhe kushtet që do të jenë aprovuar nga IDA, të cilat do të përfshijnë termat kryesore dhe kushtet e specifikuar në paragrafin (c) të këtij seksioni.

c) Termat principale të kushteve të Marrëveshjes së nënshkruar do të jenë si më poshtë: (i) termat e kohëzgjatjes së nënshkruar do të jenë njëzet (20) vjet duke përfshirë një periudhë falas prej dhjetë (10) vjetësh; (ii) interesi mbi shumën e nënshkruar të tërhequra dhe të mbetura pa u shlyer herë

pas here do të jenë në një dhe një gjysëm përqind (1-1/2%); iii) Nënhuaja do të emërtohet në dollarë; (iv) shuma fillestare e nënhuasë që do t'i shlyhet Huamarrësit, do të jetë ekuivalente në dollarë të shumës së nënhuasë së tërhequr dhe të mbetur të papaguar në datat respektive të tërheqjes nga llogaria e kredisë për llogari të shpenzimeve të bëra nga secila prej NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS në përputhje respektive me pjesët A(1) dhe B(1), A(2) dhe B(2), A(3) dhe B(3), dhe A(4) dhe B(4) të Projektit; (v) NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS do të ndërmarrin përsipër rreziqet e kursit të këmbimit të monedhës së huaj.

d) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij nën Marrëveshjet e nënhuasë në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të IDA-s dhe të rrisë qëllimet e kredisë, dhe përveçse kur IDA do të bjerë dakord për të kundërtën, Huamarrësi nuk do të nënshkruajë, amendojë, revokojë ose shfuqizojë Marrëveshjet e nënhuasë ose ndonjë nga kushtet e tyre.

Seksioni 3.02 Përveçse kur IDA do të bjerë dakord për të kundërtën, prokurimi i mallrave, punimeve e shërbimeve të konsulentit të kërkuara për projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të kredisë do të bëhet në përputhje me kushtet e shtojcës 1 të Marrëveshjes së projektit.

Seksioni 3.03 Huamarrësi dhe IDA këtu poshtë bien dakord që detyrimet parashtruar nën seksionet 9.03, 9.04, 9.05, 9.06, 9.07 dhe 9.08 të kushteve të përgjithshme (respektivisht në lidhje me siguracionin, përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, planeve dhe afateve, regjistrave dhe raporteve të mirëmbajtjes dhe blerjen e tokës) do të zbatohen nga NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS në përputhje me seksion 2.03 të Marrëveshjes së projektit.

Neni 4 **Marrëveshjet financiare**

Seksion 4.01 (a) Huamarrësi do të mbajë një sistem menaxhimi financiar, përfshirë llogaritë dhe regjistrimet dhe do të përgatisë deklaratat financiare në një formë të pranueshme nga IDA, të përshtatshme për të reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me pjesën C të projektit.

b) Huamarrësi:

(i) do të mbajë regjistrimet, llogaritë dhe deklaratat financiare referuar paragrafit (a) të këtij seksioni dhe regjistrimet dhe llogaritë për llogarinë speciale për çdo vit fiskal të audituar në përputhje me standardet e auditimit, të pranueshme për IDA-n, të zbatuara tashmë, nga auditorët e pavarur, të pranueshëm për IDA-n;

(ii) do t'i dërgojë IDA-s sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtë muaj nga fundi i çdo viti (A) kopje të certifikuara të deklaratave financiare referuar paragrafit (a) të këtij seksioni për çdo vit, siç është audituar dhe (B) një opinion mbi deklaratat, regjistrimet dhe llogaritë, dhe raportin e çdo auditimi prej auditorëve në qëllimin dhe detajet të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga IDA;

(iii) do t'i japë IDA-s çdo informacion tjetër në lidhje me këto regjistrime dhe llogari, dhe auditimet dhe auditorët, që IDA herë pas here mund të kërkojë.

c) Për të gjitha shpenzimet për çdo tërheqje nga llogaria e kredisë të bërë në bazë të deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi:

(i) do të mbajë regjistrat e tij, në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni, regjistrime dhe llogari të veçanta që reflektojnë këto shpenzime;

(ii) do të mbajë deri të paktën një vit pasi IDA të ketë marrë raportin e auditimit për vitin fiskal, në të cilin tërheqja e fundit nga llogaria e kredisë është bërë, të gjitha regjistrimet (kontratat, urdhërat, faturat, pagesat dhe dokumente të tjera) që evidentojnë këto shpenzime;

(iii) do të mundësojë përfaqësuesit e IDA-s të ekzaminojnë këto regjistrime;

(iv) do të sigurojë që këto regjistrime dhe llogari që janë përfshirë në auditimin vjetor referuar paragrafit (b) të këtij seksioni dhe që raporti, i këtij auditimi përmban një mendim të veçantë të auditorëve, për deklaratimet e shpenzimeve të paraqitura në vitin fiskal, së bashku me procedurat e kontrollit të brendshëm të përfshira në përgatitjen e tyre, mund të jenë të besueshme dhe të mbështesin tërheqjet e kryera.

Seksioni 4.02 Huamarrësi do të përgatisë ose do të ngarkojë CMU-në të përgatisë dhe të dërgojë në IDA një raport monitorimi financiar në formë dhe përbërje të pëlqyeshme për IDA-n, në të cilin:

(i) të japë burimet dhe përdorimin e fondeve të projektit, të dyja në mënyrë kumulative dhe

për periudhën e mbuluar nga raporti, duke treguar në mënyrë të ndarë fondet nga kredia dhe të shpjegojë ndryshimet ndërmjet përdorimeve aktuale dhe të planifikuara të këtyre fondeve;

(ii) të përshkruajë progresin fizik të implementimit të Projektit, të dyja në mënyrë kumulative dhe për periudhën e mbuluar nga raporti dhe të shpjegojë ndryshimet ndërmjet implementimit real dhe atij të planifikuar;

(iii) të japë statusin e prokurimeve të projektit, siç është në periudhën e fundit të raportit.

b) FMR i parë do t'i dërgohet IDA-s jo më vonë se 45 ditë pas fundit të tremujorit të parë kalendarik pas datës efektive dhe do të mbulojë periudhën kur ka ndodhur shpenzimi i parë i projektit deri në fund të tremujorit kalendarik. Çdo FMR do t'i dërgohet IDA-s jo më vonë se 45 ditë pas çdo tremujori kalendarik dhe do të mbulojë këtë tremujor kalendarik.

Seksioni 4.03 Huamarrësi: (a) do të alokojë në buxhetin operues të organizimit të buxhetit fonde për pagesë të shpenzimeve të ujit dhe të kanalizimeve; (b) do të sigurojë që këto fonde i janë paguar NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS.

Neni 5

Masat e ndërmarra nga IDA

Seksioni 5.01 Në përputhje me seksionin 6.02 (i) të kushteve të përgjithshme, janë specifikuar eventimetet e mëposhtme shtesë:

a) Nëse NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS nuk do të kenë kryer ndonjë prej detyrimeve të tyre nën Marrëveshjen e Projektit Durrës, nën Marrëveshjen e projektit Fier, nën Marrëveshjen e projektit Lezhë dhe nën Marrëveshjen e projektit Sarandë, respektivisht.

b) Nëse si rezultat i ngjarjeve, të cilat kanë ndodhur pas datës së kësaj Marrëveshjeje kredie për zhvillim, do të jetë krijuar një situatë e jashtëzakonshme, e cila do të bëjë të pamundur që NUKD, NUKF, NUKL dhe NUKS të kenë të mundur të realizojnë respektivisht detyrimet e tyre nën Marrëveshjen e Projektit Durrës, nën Marrëveshjen e projektit Fier, nën Marrëveshjen e projektit Lezhë dhe Marrëveshjen e projektit Sarandë.

c) Nëse ligji, dekreti, vendimi ose të tjera dokumente themelore të NUKD-së, duke përfshirë çdo marrëveshje rregulluese dhe ligjore, mbi të cilat këto instrumente janë bazuar ose çdo licencë të nxjerrë për NUKD-në të lidhura me Projektin, do të jenë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë në mënyrë të tillë që ndikojnë materialisht dhe kontradiktojnë aftësinë e NUKD-së për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj nën Marrëveshjen e Projektit Durrës.

d) Nëse ligji, dekreti, vendimi ose të tjera dokumente themelore të NUKF-së, duke përfshirë çdo marrëveshje rregulluese dhe ligjore mbi të cilat këto instrumente janë bazuar ose çdo licencë të nxjerrë për NUKF-në të lidhura me projektin, do të jenë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë në mënyrë të tillë që ndikojnë materialisht dhe kontradiktojnë aftësinë e NUKF-së për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj nën Marrëveshjen e projektit Fier.

e) Nëse ligji, dekreti, vendimi ose të tjera dokumente themelore të NUKL-së, duke përfshirë çdo marrëveshje rregulluese dhe ligjore mbi të cilat këto instrumente janë bazuar ose çdo licencë të nxjerrë për NUKL-në të lidhura me projektin, do të jenë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë në mënyrë të tillë që ndikojnë materialisht dhe kontradiktojnë aftësinë e NUKL-së për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj nën Marrëveshjen e projektit Lezhë.

f) Nëse ligji, dekreti, vendimi ose të tjera dokumente themelore të NUKS-së, duke përfshirë çdo marrëveshje rregulluese dhe ligjore, mbi të cilat këto instrumente janë bazuar ose çdo licencë të nxjerrë për NUKS-në të lidhura me projektin do të jenë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë në mënyrë të tillë që ndikojnë materialisht dhe kontradiktojnë aftësinë e NUKS-së për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj nën Marrëveshjen e projektit Sarandë.

g) Nëse PIP do të jetë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë pa aprovimin paraprak të IDA-s.

h) Nëse kontrata e menaxhimit do të jetë korrigjuar, pezulluar, revokuar, anuluar ose hedhur poshtë pa aprovimin paraprak të IDA-s.

Seksioni 5.02 Në përputhje me seksionin 7.01 (h) të kushteve të përgjithshme janë specifikuar eventimetet shtesë të mëposhtme:

a) nëse secila nga ngjarjet e specifikuar në paragrafët (a), (g) dhe (h) të seksionit 5.01 të kësaj

Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 ditësh mbasi njoftimi për të do të jetë dhënë nga IDA për Huamarrësin;

b) nëse do të ndodhë ndonjëra prej ngjarjeve të specifikuara në paragrafët (c), (d), (e) dhe (f) seksioni 5.01 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Data efektive, përfundimi

Seksioni 6.01 Ngjarjet e mëposhtme janë specifikuar si kushte shtesë të efektivitetit të Marrëveshjes për zhvillimin e kredisë brenda kuptimit të seksionit 12.01(b) të kushteve të përgjithshme:

a) Marrëveshja e nënhuasë Durrës është zbatuar për Palën e Huamarrësit dhe NUKD;
b) Marrëveshja e nënhuasë Fier është zbatuar për Palën e Huamarrësit dhe NUKF;
c) Marrëveshja e nënhuasë Lezhë është zbatuar për Palën e Huamarrësit dhe NUKL;
d) Marrëveshja e nënhuasë Sarandë është zbatuar për Palën e Huamarrësit dhe NUKS;
e) Kontrata e menaxhimit, që plotëson kërkesat e IDA-s dhe të Huamarrësit, është zbatuar për Palën e NUKD, NUKF, NUKL, NUKS dhe operatorin.

Seksioni 6.0 Sa më poshtë janë specifikuar si çështje shtesë, në kuptimin e seksionit 12.02 (b) të kushteve të përgjithshme, që do të përfshihen në opinionin ose opinionet me të cilat do të pajiset IDA:

a) Marrëveshja e projektit Durrës është autorizuar dhe ratifikuar si duhet nga Qarku Durrës dhe NUKD, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Qarkun Durrës dhe NUKD në përputhje me termat e saj;

b) Marrëveshja e projektit Fier është autorizuar dhe ratifikuar si duhet nga Bashkia Fier dhe NUKF, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Bashkinë Fier dhe NUKF në përputhje me termat e saj;

c) Marrëveshja e projektit Lezhë është autorizuar dhe ratifikuar si duhet nga Bashkia Lezhë dhe NUKL, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Bashkinë Lezhë dhe NUKL në përputhje me termat e saj;

d) Marrëveshja e projektit Sarandë është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Bashkia Sarandë dhe NUKS dhe është e detyrueshme ligjërisht për Bashkinë Sarandë dhe NUKS në përputhje me termat e saj;

e) Marrëveshja e nënhuasë Durrës është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe NUKD, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Huamarrësin dhe NUKD në përputhje me termat e saj;

f) Marrëveshja e nënhuasë Fier është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe NUKF, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Huamarrësin dhe NUKF në përputhje me termat e saj;

g) Marrëveshja e nënhuasë Lezhë është e autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe NUKL, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Huamarrësin dhe NUKL në përputhje me termat e saj;

h) Marrëveshja e nënhuasë Sarandë është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe NUKS, dhe është e detyrueshme ligjërisht për Huamarrësin dhe NUKS në përputhje me termat e saj.

Seksioni 6.03 Data (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu poshtë për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesit e Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01 Ministri i Financave të Huamarrësit është emëruar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

TiranëFaks:
Shqipëri355 42 28494
Për IDA:
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillimin
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
SHBA
Adresa telefonike:Telex:Faks:
INDEVAS248423(MCI) ose(202) 477 6391
Washington, D.C.64145 (MCI)

Në prani të tyre, Palët këtu poshtë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre respektivë në Distriktin e Kolumbisë, SHBA, në ditën dhe në vitin e shkruar më sipër.

Shqipëri
Nga Fatos Tarifa
Ambasadori shqiptar
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Përfaqësuesi i autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillimin

Shtojca 1

TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË KREDISË

1. Tabela e mëposhtme parashtron kategoritë e zërave që do të financohen nga të ardhurat e kredisë, alokimi i shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindja e shpenzimeve për artikujt që do të financohen nën çdo kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (të shprehura në SDR ekuivalente)	% e shpenzimeve për t'u financuar
1) Punimet		85 %
a) Për pjesën A.1 të projektit	1 030 000	
b) Për pjesën A.2 të projektit	520 000	
c) Për pjesën A.3 të projektit	260 000	
d) Për pjesën A.4 të projektit	260 000	
e) Për pjesën C të projektit	120 000	
2) Mallrat		
a) Për pjesën A.1 të projektit	1 420 000	100% shpenzimet
b) Për pjesën A.2 të projektit	720 000	e huaja
c) Për pjesën A.3 të projektit	360 000	100% shpenzimet
d) Për pjesën A.4 të projektit	360 000	lokale (kosto jashtë fabrikës)

e) Për pjesën C të projektit	290 000	dhe 50% shpenzimet lokale për artikujt e tjerë të prokuruar lokalisht 90%
3) Shërbimet e konsulencës		
a) Për sektorin e ujërave ruralë	350 000	
b) Për pjesën A.1 të projektit	300 000	
c) Për pjesën A.2 të projektit	150 000	
d) Për pjesën A.3 të projektit	75 000	
e) Për pjesën A.4 të projektit	75 000	
f) për të tjerat	400 000	
4) Rifinancimi i parapagimit të përgatitjes së Projektit	380 000	Shumat e duhura sipas seksionit 2.02 (d) të kësaj Marrëveshjeje 90%
5) Shërbimet e menaxhimit		
a) Për pjesën B.1 të projektit	1 500 000	
b) Për pjesën B.2 të projektit	750 000	
c) Për pjesën B.3 të projektit	375 000	
d) Për pjesën B.4 të projektit	375 000	
Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (të shprehura në SDR ekuivalente)	% e shpenzimeve për t'u financuar
6) Kostot operacionale në rritje	230 000	75%
7) Paalokuar	1 100 000	
Total	11 400 000	

2. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) Termi “shpenzimet e huaja” do të thotë shpenzimet në monedhën e çdo vendi e ndryshme nga monedha e vendit të Huamarrësit për mallrat ose shërbimet të siguruar nga territori i ndonjë vendi i ndryshëm nga ai i Huamarrësit.

b) Termi “shpenzimet lokale” do të thotë shpenzimet në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat, ose për shërbimet e siguruar nga territori i Huamarrësit.

c) Termi “shërbimet e menaxhimit” do të thotë shërbimet nën kontratën e menaxhimit nën pjesën B të projektit.

d) Termi “kosto operacionale në rritje” do të thotë shpenzimet operacionale të bëra nga CMU-ja për llogari të menaxhimit të zbatimit të projektit për komunikimin, entet, printimet, publikimet, qira zyrash, mirëmbajtje dhe furnizime, sistemet e sigurisë së zyrës, përdorimi i automjeteve dhe mirëmbajtje, transportimi dhe shpenzimet për inspektimet në terren, trajnimi i stafit të CMU-së për qëllimet e menaxhimit të Projektit, shpërblimit të stafit, duke përfshirë sigurimet shoqërore, por duke përfshirë pagesat për punonjësit me status civil dhe auditimet, dhe të tjera shpenzime të tilla, siç mund të bihet dakord nga IDA.

3. Pavarësisht nga kushtet e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet përse i përket:

a) pagesave të shpenzimeve të bëra përpara datës së kësaj Marrëveshjeje;

b) pagesave të bëra për shpenzimet nën kategorinë (3)(a) për sektorin e ujërave rurale, nëse nuk është aprovuar nga Huamarrësi strategjia për furnizimin me ujë dhe kanalizimet të zonave rurale;

c) pagesave të bëra për shpenzimet nën kategoritë (1)(C) dhe (2)(C) për pjesën A.3 të Projektit, nëse nuk është bërë efektiv, në përputhje me kërkesat e IDA-s, rregullimi i tarifës për vitin fiskal 2003 në Bashkinë e Lezhës.

4. IDA mund të kërkojë tërheqje nga llogaria e kredisë që bëhet mbi bazat e deklaratave të shpenzimeve: a) për mallrat nën kontratë që kushtojnë më pak se \$ 100 000 ekuivalente secila; b) për punimet nën kontrata që kushtojnë më pak se \$ 500 000 ekuivalente secila; c) për shërbimet për firmat

kontrata që kushtojnë më pak se \$ 100 000 ekuivalente secila; d) për shërbimet për individët nën kontrata që kushtojnë më pak se \$ 50 000 secila; e) për kostot operacionale në rritje; f) për trajnimin; g) për auditimin në termat dhe kushtet që IDA do të specifikojë nëpërmjet njoftimit për Huamarrësin.

Shtojca 2

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i projektit është të përmirësojë sigurinë, besueshmërinë, efikasitetin, cilësinë dhe potencialin financiar të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në Durrës, Fier, Lezhë dhe Sarandë.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, subjekt i modifikimeve sipas të cilave mund të bjerë dakord Huamarrësi dhe IDA ndërmjet tyre herë pas here në arritjen e këtyre objektivave:

Pjesa A: Fondi i investimeve të sistemit të furnizimit me ujë dhe infrastrukturës.

1. Ngritja e fondit të investimeve për rehabilitimin, zgjerimin dhe përmirësimin e efikasitetit të faciliteteve dhe shërbimit të sistemit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët në Durrës, duke përfshirë: a) projektimin, implementimin dhe supervizionin e riparimeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; b) riparimet, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; c) pajisje të kontrollit dhe matjes së ujit (ujëmatës të mëdhenj dhe individualë); d) projektimin, vlerësimin, instalimin dhe funksionimin e sistemeve teknike administrative financiare komerciale dhe të shërbimit me klientët të furnizimit me ujë dhe kanalizime; e) pajisjet për operimin dhe konstruksionin, materialet dhe pjesët e këmbimit, funksionet administrative dhe të tjera; f) planifikimi i investimeve; g) trajnimi i stafit.

2. Ngritja e fondit të investimeve për rehabilitimin, zgjerimin dhe përmirësimin e efikasitetit të faciliteteve dhe shërbimit të sistemit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët në Fier, duke përfshirë: a) projektimin, implementimin dhe supervizionin e riparimeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; b) riparimet, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; c) pajisje të kontrollit dhe matjes së ujit (ujëmatës të mëdhenj dhe individualë); d) projektimin, vlerësimin, instalimin dhe funksionimin e sistemeve teknike administrative financiare komerciale dhe të shërbimit me klientët të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; e) pajisjet për operimin dhe konstruksionin, materialet dhe pjesët e këmbimit, funksionet administrative dhe të tjera; f) planifikimi i investimeve; g) trajnimi i stafit.

3. Ngritja e fondit të investimeve për rehabilitimin, zgjerimin dhe përmirësimin e efikasitetit të faciliteteve dhe shërbimeve të sistemit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët në Lezhë, duke përfshirë: a) projektimin, implementimin dhe supervizionin e riparimeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; b) riparimet, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; c) pajisje të kontrollit dhe matjes së ujit (ujëmatës të mëdhenj dhe individualë); d) projektimin, vlerësimin, instalimin dhe funksionimin e sistemeve teknike administrative financiare komerciale dhe të shërbimit me klientët të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; e) pajisjet për operimin dhe konstruksionin, materialet dhe pjesët e këmbimit, funksionet administrative dhe të tjera; f) planifikimi i investimeve; g) trajnimi i stafit.

4. Ngritja e fondit të investimeve për rehabilitimin, zgjerimin dhe përmirësimin e efikasitetit të faciliteteve dhe shërbimit të sistemit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët në Sarandë, duke përfshirë: a) projektimin, implementimin dhe supervizionin e riparimeve, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; b) riparimet, rehabilitimin dhe zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; c) pajisje të kontrollit dhe matjes së ujit (ujëmatës të mëdhenj dhe individuale); d) projektimin, vlerësimin, instalimin dhe funksionimin e sistemeve teknike administrative financiare komerciale dhe të shërbimit me klientët të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; e) pajisjet për operimin dhe konstruksionin, materialet dhe pjesët e këmbimit, funksionet administrative dhe të tjera; f) planifikimi i investimeve; g) trajnimi i stafit.

PJESA B: KONTRATA E MENAXHIMIT

1. Sigurimi i shërbimeve në Durrës për:

a) funksionimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
b) mirëmbajtjen e faciliteteve dhe zhvillimin e programeve të duhura të mirëmbajtjes dhe të menaxhimit për facilitetet;

c) zhvillimin e programeve të menaxhimit për të trajnuar dhe çuar përpara aftësitë e stafit të NUKD-së;

d) kryerjen e të gjitha faturimeve, arkëtimeve dhe marrëdhënieve me konsumatorin dhe funksioneve të shërbimit të lidhura me konsumatorët në zonat e shërbimit, përsa i përket shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve;

e) marrjen e të gjitha përgjegjësiave financiare, menaxhuese dhe administrative që kanë të bëjnë me NUKD-në;

f) planifikimin, prokurimin dhe menaxhimin e programit të implementimit të zbatuar nën fondin e investimeve;

g) sigurimin e asistencës dhe këshillimit për NUKD-në mbi të gjitha çështjet e lidhura me NUKD-në, shërbimet dhe ndonjë kërkesë për informacion, këshilla ose raporte nga rregulloret e NUKD-së përsa i përket faciliteteve ose shërbimeve.

2. Sigurimi i shërbimeve në Fier për:

a) funksionimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

b) mirëmbajtjen e faciliteteve dhe zhvillimin e programeve të duhura të mirëmbajtjes dhe të menaxhimit për facilitetet;

c) zhvillimin e programeve të menaxhimit për të trajnuar dhe çuar përpara aftësitë e stafit të NUKF-së;

d) kryerjen e të gjitha faturimeve, arkëtimeve dhe marrëdhënieve me konsumatorin dhe funksioneve të shërbimit të lidhura me konsumatorët në zonat e shërbimit, përsa i përket shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve;

e) marrjen e të gjitha përgjegjësiave financiare, menaxhuese dhe administrative që kanë të bëjnë me NUKF-në;

f) planifikimin, prokurimin dhe menaxhimin e programit të implementimit të zbatuar nën fondin e investimeve;

g) sigurimin e asistencës dhe këshillimit për NUKF-në mbi të gjitha çështjet e lidhura me NUKF-në, shërbimet dhe ndonjë kërkesë për informacion, këshilla ose raporte nga rregulloret e NUKF-së përsa i përket faciliteteve ose shërbimeve.

3. Sigurimi i shërbimeve në Lezhë për:

a) funksionimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

b) mirëmbajtjen e faciliteteve dhe zhvillimin e programeve të duhura të mirëmbajtjes dhe të menaxhimit për facilitetet;

c) zhvillimin e programeve të menaxhimit për të trajnuar dhe çuar përpara aftësitë e stafit të NUKL-së;

d) kryerjen e të gjitha faturimeve, arkëtimeve dhe marrëdhënieve me konsumatorin dhe funksioneve të shërbimit të lidhura me konsumatorët në zonat e shërbimit, përsa i përket shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve;

e) marrjen e të gjitha përgjegjësiave financiare, menaxhuese dhe administrative që kanë të bëjnë me NUKL-në;

f) planifikimin, prokurimin dhe menaxhimin e programit të implementimit të zbatuar nën fondin e investimeve;

g) sigurimin e asistencës dhe këshillimit për NUKL-në mbi të gjitha çështjet e lidhura me NUKL-në, shërbimet dhe ndonjë kërkesë për informacion, këshilla ose raporte nga rregulloret e NUKL-së, përsa i përket faciliteteve ose shërbimeve.

Sigurimi i shërbimeve në Sarandë për:

a) funksionimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

b) mirëmbajtjen e faciliteteve dhe zhvillimin e programeve të duhura të mirëmbajtjes dhe të menaxhimit për facilitetet;

c) zhvillimin e programeve të menaxhimit për të trajnuar dhe çuar përpara aftësitë e stafit të NUKS-në;

d) kryerjen e të gjitha faturimeve, arkëtimeve dhe marrëdhënieve me konsumatorin dhe funksioneve të shërbimit të lidhura me konsumatorët në zonat e shërbimit, përsa i përket shërbimeve të

ujit dhe të kanalizimeve;

e) marrjen e të gjitha përgjegjësiave financiare, menaxhuese dhe administrative që kanë të bëjnë me NUKS-në;

f) planifikimin, prokurimin dhe menaxhimin e programit të implementimit të zbatuar nën fondin e investimeve;

g) sigurimin e asistencës dhe këshillimit për NUKS-në mbi të gjitha çështjet e lidhura me NUKS-në, shërbimet dhe ndonjë kërkesë për informacion, këshilla ose raporte nga rregulloret e NUKS-së përse i përket faciliteteve ose shërbimeve.

PJESA C: MENAXHIMI I PROJEKTIT

Sigurimi i asistencës teknike, duke përfshirë shërbimet e auditimit dhe kostot operationale në rritje për CMU-në për menaxhimin e projektit.

Projekti pritet të përfundojë në 30 qershor 2009.

Shtojca 3

PROGRAMI I IMPLEMENTIMIT

1. Huamarrësi:

a) do të ndjekë politika dhe procedura të përshtatshme për të monitoruar dhe vlerësuar në baza të vazhdueshme, në përputhje me treguesit që plotësojnë kërkesat e IDA-s, zbatimin e Projektit dhe arritjen e objektivave të tij;

b) do të përgatisë, nën termat e referencës që plotësojnë kërkesat e IDA-s dhe të pajisë IDA-n në ose rreth datës 30 prill 2005, një raport që përmbledh rezultatet e veprimtarive monitoruese dhe vlerësuese të kryera në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni, mbi progresin e arritur në zbatimin e projektit gjatë periudhës deri në datën e raportit të cituar këtu dhe të përcaktojë masat e rekomandueshme për të siguruar zbatimin me efikasitet të projektit dhe arritjen e objektivave të tij për periudhën në vazhdim të kësaj date të nxjerrjes së raportit;

c) do të rishikojë me IDA-n më 31 korrik 2005 ose në një datë të tillë të mëvonshme, siç do të kërkohej nga IDA, raportin referuar në paragrafin (b) të këtij seksioni dhe, më pas të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar përfundimin me efikasitet të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij, të bazuara në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të cituar dhe pikëpamjet e IDA-s mbi këtë çështje.

2. Huamarrësi do të sigurojë që të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e EMPF-së në terma kohore.

3. Huamarrësi do të detyrojë Komitetin ekzekutiv që: (a) të sigurojë që auditimet tekniko-financiare të performancës së operatorit do të zbatohen në baza vjetore, i pari nga këto auditimet do të përfundohet në 30 qershor 2004 ose në një datë të tillë të mëvonshme, siç mund të bihet dakord me IDA-n, nga auditorë të pavarur të pranueshëm për IDA-n, nën termat e referencës së pranueshme për IDA-n; (b) pas kësaj, të paraqesë rezultatet e këtyre auditimeve tek IDA për të bërë rishikimin e saj.

Shtojca 4

LLOGARIA SPECIALE

1. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) Termi “kategori e ligjshme” do të thotë kategoria (1) deri (6) parashtruar në tabelë në paragrafin 1 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Termi “shpenzime të ligjshme” do të thotë shpenzime në përputhje me kostot e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe për t’u financuar nga të ardhurat e kredisë alokuar herë pas here në kategoritë e ligjshme në përputhje me kushtet e shtojcës 1 të kësaj

Marrëveshjeje.

c) Termi “alokim i autorizuar”, do të thotë një shumë ekuivalente me 500 000 \$ që do të tërhiqet nga llogaria e kredisë dhe depozitohet në llogarinë speciale në përputhje me paragrafin 3(a) të kësaj shtojce, me kushtin që, sidoqoftë, me përjashtim të rasteve kur IDA do të bjerë dakord për të kundërtën, alokimi i autorizuar do të kufizohet në një shumë ekuivalente me 250 000 \$ derisa shuma e përgjithshme e tërheqjeve nga llogaria e kredisë plus shumën totale të të gjithë komponentëve të prokuruar të papaguar të kryera nga IDA në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme do të jetë e barabartë me ose do ta kalojë një shumë ekuivalente me SDR 2 300 000.

2. Pagesat jashtë llogarisë speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzimet e ligjshme në përputhje me kushtet e kësaj shtojce.

3. Pasi IDA të ketë siguruar evidenca të përshtatshme për të, që llogaria speciale është hapur siç duhet, tërheqjet e alokimit të autorizuar dhe tërheqjet në vazhdim për të rimbushur llogarinë speciale do të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqjet e alokimit të autorizuar, Huamarrësi do të pajisë IDA-n me një kërkesë ose kërkesa për të depozituar në llogarinë speciale një shumë ose shuma, të cilat nuk e kalojnë shumën e përgjithshme të shumës së alokimit të autorizuar. Në bazë të një kërkesë të tillë ose kërkesave, IDA, për Palën e Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale një shumë ose shuma të tilla siç ka kërkuar Huamarrësi.

b) (i) Për rimbushjen e llogarisë speciale, Huamarrësi do të paraqesë për IDA-n kërkesat për depozitim në llogarinë speciale në intervale të tilla siç do t'i specifikojë IDA.

(ii) Përpara se, ose në kohën e çdo kërkesë të tillë, Huamarrësi do të pajisë IDA-n me dokumente dhe të tjera evidenca të kërkuara në përputhje me paragrafin 4 të kësaj shtojce për pagesën ose pagesat në respekt të të cilave është kërkuar rimbushja. Në bazë të çdo kërkesë të tillë, IDA, për Palën e Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale një shumë të tillë siç do të ketë kërkuar Huamarrësi dhe siç do të jetë treguar nga dokumentet e cituara dhe evidenca të tjera që do të paguhet jashtë llogarisë speciale për shpenzimet e përshtatshme. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen nga IDA nga llogaria e kredisë nën kategoritë respektive të përshtatshme dhe në shumat respektive ekuivalente, siç do të jenë justifikuar nga dokumentet e cituara dhe të tjera evidenca.

4. Për secilën pagesë të bërë nga Huamarrësi jashtë llogarisë speciale, Huamarrësi, në një kohë të tillë siç mund ta kërkojë IDA në mënyrë të arsyeshme, do të furnizojë për IDA-n dokumente të tilla dhe të tjera evidenca, që tregojnë që këto pagesa janë bërë ekskluzivisht për shpenzimet e ligjshme.

5. Pavarësisht nga kushtet e paragrafit 3 të kësaj shtojce, IDA-s nuk do t'i kërkohej të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale:

a) nëse, në ndonjë kohë, IDA do të ketë vendosur që të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhet të bëhen nga Huamarrësi direkt nga llogaria e kredisë në përputhje me kushtet e nenit 5 të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje.

b) në qoftë se Huamarrësi nuk do të ketë pajisur IDA-n, brenda periudhës së kohës së specifikuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, me ndonjërin nga raportet e auditimit të kërkuara nga IDA në përputhje me seksionin e cituar që i përket auditimit të regjistrave dhe llogarive për llogarinë speciale;

c) nëse në ndonjë moment, IDA do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj për të pezulluar të gjithë ose një pjesë të së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqjet nga llogaria e kredisë në përputhje me kushtet e seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme;

d) menjëherë sapo totali i patërhequr i shumës së kredisë së alokuar për kategoritë e ligjshme, minus totalin e shumës së të gjithë komponentëve të prokuruar të papaguar të bërë nga IDA, në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të përgjithshme për Projektin, do të barazojnë dy herë shumën e alokimit të autorizuar.

Që këtej e tutje, tërheqja nga llogaria e kredisë së shumës së mbetur të patërhequr të kredisë së alokuar për kategoritë e ligjshme, do të ndjekë procedura të tilla siç do t'i specifikojë IDA nëpërmjet njoftimit për Huamarrësin. Të tilla tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe me kushtin që do të jetë plotësuar kërkesa e IDA-s që të gjitha këto shuma të mbetura të depozituara në llogarinë speciale deri në datën e dhënies së një njoftimi të tillë do të përdoren për bërjen e pagesës për shpenzimet e ligjshme.

6.(a) Në qoftë se IDA do të ketë vendosur ndonjëherë që çdo pagesë jashtë llogarisë speciale:

i) është bërë për një shpenzim ose në një shumë të papërshtatshme në përputhje me paragrafin 2 të kësaj shtojce ose ii) nuk është justifikuar nga evidencat e paraqitura për IDA-n, Huamarrësi, menjëherë me marrjen e njoftimit nga IDA: (A) do të sigurojë evidenca të tilla shtesë siç mund të kërkojë IDA ose (B) do të depozitojë në llogarinë speciale (ose, nëse IDA do ta kërkojë, rifinancojë për IDA-n) një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë ose pjesë të saj jo të përshtatshme ose të pajustificuara. Nëse IDA nuk do të vendosë për të kundërtën, asnjë depozitë e mëtejshme nuk do të bëhet nga IDA në llogarinë speciale, derisa Huamarrësi t'i ketë siguruar këto evidenca ose të ketë bërë një depozitë ose rifinancim të tillë, sipas rastit.

b) Nëse IDA do të vendosë në ndonjë moment që ndonjë shumë e mbetur e papaguar nga llogaria e veçantë nuk do të jetë e nevojshme për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzimet e ligjshme, Huamarrësi, menjëherë me marrjen e njoftimit nga IDA, do të rifinancojë IDA-n me një shumë të tillë të mbetur të papaguar.

c) Huamarrësi mundet, me marrjen e njoftimit nga IDA, të rifinancojë IDA-n me të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në llogarinë speciale.

d) Rifinancimet e IDA-s të bëra në përputhje me paragrafët 6(a), (b) dhe (c) të kësaj shtojce do të jenë të kredituara në llogarinë e kredisë për tërheqje të mëtejshme ose për anulimin në përputhje me kushtet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë kushtet e përgjithshme.

NDREQJE GABIMI

Në ligjin nr.8991, datë 23.1.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, shkurt 2003 (faqe 157), në nenin 9, pika 10 hiqen fjalët “për miratim në KRRT”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 18.7.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë